1Ҁ3

REPUBLIKAESHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
DREJTORIA JURIDIKE

Nr 9815 Prot                                                                 Vlorë, më 19.06 2025

**PROJEKTVENDIM**
**Nr____, Datë ___.___.2025**

**"PËR MIRATIMIN E DISA RRUGËVE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË"**

Bazuar në Ligjin nr.139/2015 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar neni 8, neni 9.1, pika 1.1/a dhe b, pika 1.7/b, neni 54 pika ll; me propozim të shoqatave, subjekteve dhe individëve të ndryshëm si dhe të miratuara nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit të Këshillit të Bashkisë me Vendimet Nr.1, datë 08.07.2024, Nr.2, date 20.11.2024, Nr.4, datë 10.06.2025 si dhe në relacionin e paraqitur nga Sekretariati i Këshillit të Bashkisë së bashku me dokumentacionin shoqërues, Këshilli i Bashkisë Vlorë në mbledhjen e datës . .2025.

**VENDOSI:**

1. Të miratojë emërtimin e disa rrugëve në territorin e Bashkisë Vlorë si më poshtë:

a. Rruga "Kujtim Laro"... në Rajonin Nr.5, sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, bashkëlidhur këtij vendimi.
b. Rruga "Fatos Arapi" në Rajonin Nr.3, sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, bashkëlidhur këtij vendimi.
c. Rruga "Lefter Cipa" në Rajonin Nr.2,sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, bashkëlidhur këtij vendimi.
d. Rruga "Bejkush Birce" në Rajonin Nr.4, sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, bashkëlidhur këtij vendimi.
e. Rruga "Dule Dalani" në Rajonin Nr.1, sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, bashkëlidhur këtij vendimi.
f. Rruga "Lelo Hadër Habilaj" në Rajonin Nr.5, sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, bashkëlidhur këtij vendimi.
g. Rruga "Qafa e Shegës", fshati Tragjas,Nj.A. Orikum sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, bashkëlidhur këtij vendimi.

h. Rruga "Lugu i Gjonet" fshati Tragjas, NJ.A. Orikum sipas planvendosjes së përgatitur nga Drejtoria e Urbanistikës, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari dhe Administrata e Bashkisë Vlorë.

3. Ky vendim hyn ne fuqi bazuar në ligjin 139/2015, date 17.12.2025, "Për Vetëqeverisjen Vendore", neni55, pika 6.

**KRYETAR**
**Ermal Dredha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VLORË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

DREJTORIA JURIDIKE

Nr. 9815 prot  Vlorë, më 19.06.2025

**RELACION**

**MBI PROJEKTVENDIMIN**

**"PËR EMËRTIMIN E DISA RRUGËVE NË TERRITORIN E BASHKISË VLORË"**

Para Këshillit të Bashkisë Vlorë

Të nderuar këshilltarë,

Projektvendimi për emërtimin e disa rrugëve në territorin e Bashkisë Vlorë, të cilin e paraqesim për miratim, lidhet me emrat e personaliteteve të shquara të qytetit si dhe njerëz të cilët kanë dhënë jetën në periudha të ndryshme historike për clirimin dhe mbrojtjen e atdheut. Propozimet e ardhura për emërtim të rrugëve janë të periudhave të ndryshme në vitet 2024-2025, por për shkak të evidentimit në terren të rrugëve të pa emërtuara ose me emërtime të pa sakta është vonuar propozimi i Administratës së Bashkisë për vendimmarrjen përkatëse nga ana e këtij Këshilli. Gjithashtu jemi kufizuar edhe për shkak të zgjedhjeve te datës 11 Maj, me qëllim që të mos interpretohej se emërtimi i rrugëve do të përdorej për qëllime elektorale.

Në funksion të njohjes nga ana e anëtarëve të Këshillit të Bashkisë, të kontributit të secilit nga personalitetet që janë propozuar nga shoqata, institucione ose individë (këshilltare) po ju paraqesim shkurtimisht çka përfaqëson secili prej tyre.

1.Propozimi për emërtim rruge me emrin Kujtim Laro është i shoqatës së shkrimtarëve dhe i artistëve "Petro Marko"Vlorë. Ky propozim lidhet me një ndër bijtë më të shquar të qytetit tonë dhe një ndër kopozitorët më të shquar të Shqipërisë. Ai eshte dekoruar me titullin "Artist i Merituar" dhe "Naim Frasheri" i klasit te parë, për krijimtarinë e tij në

gjinitë e ndryshme muzikore. Ka lidur ne vitin 1947 ne qytetin e Vlorës dhe pas përfundimit të institutit të lartë të arteve ka punuar në Akademinë e Arteve, Asamblin e Ushtrise etj. Është autor i kolonave zanore të dhjetra filmave shqiptarë si: "Liri a vdekje", "Nëntori i Dytë", "Lulëkuqet mbi mure", si dhe dhjetra këngëve në festivale të ndryshme. Propozimi është miratuar dhe nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendor të Nderit pranë Keshillit të Bashkisë me vendimin nr.1, datë 08.07.2024.

Kujtim Laro nuk i shkeputi asnjëherë lidhjet me qytetin e lindjes dhe, edhe pse ishte artist i madh, gjithe jeten u karakterizua nga modestia dhe thjeshtësia si njeri.

Propozimi për emërtim rruge me emrin Fatos Arapi, është i shoqatës së shkrimtarëve dhe i artistëve "Petro Marko" Vlorë. Ky propozim është miratuar dhe nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendor të Nderit pranë Keshillit të Bashkisë, me vendimin nr 1, datë 08.07.2024.

2.Fatos Arapi është një ndër personalitet e shquara të letërsisë shqipe dhe njihet si nje ndër poetët më të mëdhenj të Shqipërisë.

Ai ka lindur në Zvërnec të Vlorës dhe, në këtë qytet ka kryer arsimin e mesëm. Gjithashtu ka ushtruar profesionin e mesuesit në shkollën "Ismail Qemali" Vlorë. Krahas veprimtarisë krijuese si shkrimëtar ka shërbyer në institucione të ndryshme shtetërore dhe arsimore si në Komisionin e Planit të Shtetit, Pedagog ne Institutin Bujqësor ,Kamzë dhe në "Universitetin e Tiranës"etj, në të cilat ka punuar me përkushtim maksimal.

Nga viti 1962 e në vijim ka shkruar me dhjetra vepra artistike si vëllime poetike, përkthime e të tjera. Në vitin 2008 ka fituar "Kurorën e Artë" në manifestimin poetik, "Mbrëmjet e Poezise Strugane". Ai ka mbajtur vazhdimisht lidhje me qytetin e lindjes dhe me punën dhe vepren e tij ka kontribuar për promovimin e qytetit të Vlorës.

3.Edhe propozimi për emërtim rruge me emrin Lefter Cipa është i shoqatës së shkrimtarëve dhe i artistëve "Petro Marko" Vlorë. Gjithashtu ky propozim është miratuar dhe nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendor të Nderit pranë Keshillit të Bashkisë me vendimin nr1, datë 08.07.2024.

Ky propozim lidhet me një ndër etnofolkloristët më të shquar të trashgimnisë kulturore, Lefter Cipa. Ai është një poet dhe folklorist i shquar i njohur padikutim ne nivel kombëtar por edhe ndërkombëtar. Ai është autori i disa librave si "Bejkë e Bardhë", "Blibilat e vendit tim", "Për Kosoven prapë do te ngihem", "Shqipëri moj ballë hapur"etj. Është gjithashtu autori i teksteve të dhjetra këngëve të kënduara në festivalet folklorike të cilat janë bërë popullore në mbarë vendin tonë. Për të gjitha keto është dekoruar me cmime dhe dekorata te ndryshme, deri në Dekoratën "Nderi i Kombit".

4.Një ndër propozimet për emërtim rruge lidhet me emrin e trajnerit te shquar te futbollit Vlonjat dhe Kombëtar Bejkush Birçe. Propozimi për emërtim rruge me emrin Bejkush Birçe, është i Shoqatës së shkrimtarëve dhe i artistëve "Petro Marko" Vlorë, si dhe Shoqatës Atdhetare Kulturore Bolena Vlorë . Propozimi është miratuar dhe nga

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendor të Nderit,pranë Keshillit të Bashkisë me Vendimin Nr1, datë 08.07.2024.

Bejkush Birçe ka dhënë kontribut të spikantur vecanërisht në fushën e sportit (futbollit). Kariera e tij si futbollist por vecanërisht si trajner i disa skuadrave si Flamurtari i qytetit të Vlorës dhe ekipit kombëtar ka lënë gjurmë në historinë e sportit shqiptar. Ai asnjëherë nuk i shkëputi lidhjet me qytetin e Vlorës dhe vecanërisht me ekpin e futbollit te këtij qyteti. Mund të thuhet se është një personalitet i njojur jo vetë për qytetin e Vlorës por ne gjithë Shqipërinë.

5.Porpozimi për emërtimin e një rruge me emrin e dëshmorit të atdheut Dule Dalani është bërë nga shoqata atdhetare "Lopsi" dhe është miratur me vendimin nr.2, datë 20.11.2024 të Komisionit Këshillimor per Tituj Vendor të Nderit pranë Këshillit të Bashkisë.

Dëshmori Dule Dalani është ndër ata patriot i cili ka luftuar me armë në dorë duke marrë pjesë në të gjitha luftrat e zhvilluara në jugun e Shqiperisë për mbrojtjen e tërësisë territoriale prej vitit 1889 deri në vitin 1920. Ai ka marre pjese ne levizjen kombëtare kunder forcave turke ne vitin 1890 si dhe në vitet 1912-1913 ne krahinen Kuç- Himarë. Në vitin 1914 ka luftuar kunder forcave greke për clirimin e Tepelenës, ku edhe është plagosur. Në vitin 1920,ishte komandant cete ,në luftën për clirimin e Vlorës nga pushtuesit italianë, ku dhe u vra ne Qershor 1920. Ai është nderuar me tituj dhe medalje të ndryshme si"Urdhri i Klasit të Parë". "Nderi i Kombit"etj.

6.Shoqata atdhetare Kulturore "Laberia" Dega Vlorë si dhe organizata e Deshmorëve të Luftës Nacionale çlirimtare kanë propozuar emërtimin e një rruge në qytetin e Vlorës me emrin e dëshmorit Lelo Hadër Hablilaj. Dëshmori Lelo Hader Habilaj ishte vetëm 16 vjeç kur dha jetën për çlirimin e atdheut. Edhe babai i tij Hadër Habilaj ka marrë pjesë në luftën e vitit 1920. Ky propozim është shqyrtuar dhe miratuar edhe nga Komisioni Këshillimor për Titujt Vendor të Nderit pranë Këshillit të Bashkisë me vendimin nr.2, datë 20.11.2024.

7.Me propozim të administratorit te Nj.A Orikum është propozuar emërtimi i dy rrugëve rurale ne territorin e Nj.A Orikum. Ky propozim ka si qëllim që këto rrugë të njihen zyrtarisht si rrugë publike me qëllim evitimin e ndërhyrjeve nga persona të ndryshëm të cilët bllokojnë kalimin e banorëve në territorin përkatës. Emërtimi i këtyre rrugëve sipas planvendosjeve përkatëse të jetë me emërtime tradicionale: "Qafa e Shegës" dhe" Lugu i Gjonet"

8.Shoqata Atdhetare kulturore "Ismail Qemali" Vlorë, ka propozuar emërtimin e një rruge me emrin e dëshmorit Ibrahim Skendaj(Aliu). Ibrahim Aliu është një ndër mësuesit e parë të gjuhës shqipe në qytetin e Vlorës. Gjithashtu është një ndër personalitetet që ka luftuar për çështjen kombëtare. Është një ndër organizatorët e Komitetit të Mbrojtjes në luftën e Vlorës në vitin 1920. Ishte mbështetës i Luftës Nacionale Çlirimtare dhe për këtë shkak u internua në kampin famëkeq Mathausen, ku edhe vdiq në vitin 1945.

Të nderuar Këshilltarë

Përsa parashtruam më lartë i propozojmë Këshillit të Bashkisë të miratoj këtë projektvendim si shprehje e vlerësimit të Bashkisë Vlorë dhe veçanerisht të Këshillit të Bashkisë, për këto personalitete të shquara si dhe dëshmorët e atdheut me arsyetimin se emrat e tyre i bëjnë nder edhe vetë qytetit tonë.

Informacioni më i detajuar gjendet në dokumentacionin bashkëlidhur këtij projektvendimi.

**KRYETAR**

**Ermal Dredha**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA VLORË

**R E P U B L I K A E SH Q I P Ë R I S Ë**
**BASHKIA VLORË**

Nr 18998 Prot                                                                 Vlorë, më 21.11.2024

**VENDIM**
**Nr 2, Datë 20.11.2024**

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit , pranë Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 20.11.2024, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura,

**VENDOSI:**

Të miratojë propozimet e paraqitura , si më poshtë:

1.Emërtim rruge në qytet me emrin "Ibrahim Skëndaj(Aliu) "
2.Emërtim sheshi në qytet me emrin "Ali Asllani "
3.Emërtim rruge në qytet me emrin "Dule Dalani"
4.Vlerësim me Titullin " Personalitet i Shquar " zotit Veli Resul Dervishaj.
5. Vlerësim me Titullin " Personalitet i Shquar " zotit Osman Banushi.
6.Emërtim rruge në qytet me emrin "Lelo Hadër Habilaj "

Ky Vendim ti përcillet administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë , për procdurat e mëtejshme ligjore , bazuar në dispozitat ligjore ne fuqi.

**KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR**
**Bardhosh Gaçe**

**REPUBLIKAESHQIPËRISË**
**BASHKIA VLORË**

Nr 9592 Prot Vlorë, më 17. 06. 2025

**VENDIM**
**Nr 4, Datë 10.06.2025**

Bazuar në Rregulloren e Komisionit Këshillimor "Për titujt vendorë të nderit, kriteret dhe procedurën e dhënies së tyre, si dhe për emertimin e rrugëve, shesheve, territoreve, institucioneve dhe objekteve në juridiksionin e Bashkisë Vlorë", neni 10, pika 4 e në vijim, si dhe në propozimet e institucioneve, shoqatve dhe individëve për vlerësimin e personaliteteve të njohura në qytetin e Vlorës, Komisioni Këshillimor për Titujt Vendor të Nderit, pranë Keshillit të Bashkisë Vlorë.

**VENDOSI:**

Të miratojë propozimet e paraqitura , si më poshtë:

1.Emërtim rruge me emrin "Qafa e Shegës në NJ.A. Orikum "
2.Emërtim rruge me emrin "Lugu i Gjonet në NJ.A Orikum"
3.Vlerësim me Titullin " Qytetar Nderi i Vlorës " Imzot Kozma Qirjo.

Ky Vendim ti përcillet Administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë , për procdurat e mëtejshme vendimmarrëse , bazuar në dispozitat ligjore ne fuqi.

**KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR**
**Bardhosh Gaçe**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr 13023 Prot                                                            Vlorë, më 19.08.2024

VENDIM
Nr 1, Datë 08.07.2024

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit, në mbledhjen e datës 08.07.2024, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura,

VENDOSI:

A-Të miratojë propozimet si më poshtë:
1.Vendosje busti për patriotin Ismail Mekati, në fshatin Brilhas.
2.Emërtimin e një rruge në qytet, me emrin Maliq Hadër Habilaj.
3.Vlerësimin me titull"Qytetar Nderi i Vlorës" Prof.Doc.Profit Canaj.
4.Emërtimin e një rruge, me emrin Bejkush Razo Birçe.
5.Emërtimin e një rruge, me emrin Fatos Arapi.
6.Emërtimin e një rruge, me emrin Lefter Çipa.
7.Emërtimin e një rruge, me emrin Kujtim Laro, kompozitor.
8.Ky Vendim ti përcillet administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë, për p[illegible] vendimmarrëse.

KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR
Bardhosh Gaçe

Adresa:Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr 13023 Prot                                                  Vlorë, më 19.08.2024

VENDIM
Nr 1, Datë 08.07.2024

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit, në mbledhjen e datës 08.07.2024, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura,

VENDOSI:

A-Të miratojë propozimet si më poshtë:
1.Vendosje busti për patriotin Ismail Mekati, në fshatin Drithas.
2.Emërtimin e një rruge në qytet, me emrin Maliq Hadër Habilaj.
3.Vlerësimin me titull"Qytetar Nderi i Vlorës" Prof.Doc.Profit Canaj.
4.Emërtimin e një rruge, me emrin Bejkush Razo Birçe.
5.Emërtimin e një rruge, me emrin Fatos Arapi.
6.Emërtimin e një rruge, me emrin Lefter Çipa.
7.Emërtimin e një ruge, me emrin Kujtim Laro, kompozitor.
8.Ky Vendim ti përcillet administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë, për p[illegible] vendimmarrëse.

KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR
Bardhosh Gaçe

Adresa:Sheshi "4 Heronjtë", www.vlora.gov.al; E-mail: info@vlora.gov.al

**SHOQATA E SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE "PETRO MARKO", VLORË**

Nr. 31 prot. Vlorë, e martë, 09. 07. 2024
Regj. nr…
Dosja: Propozime

**LËNDA: PROPOZIM PËR EMËRTIM RRUGËSH**

**KËSHILLIT TË BASHKISË, VLORË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**Z. ERMAL DREDHA**
Z. Kryetar,

Zotërinj anëtarë të këshillit bashkiak!

Shoqata e Shkrimtarëve dhe Artistëve "Petro Marko" Vlorë, e shikon të arsyeshme t'ju drejtohet juve, që në Qytetin "Nderi i Kombit" të Vlorës, që, midis emrave të nderuar të traditës dhe historisë, në këtë 80 vjetor të Çlirimit të Atdheut, të vendosen në rrugë të mundshme dhe të duhura të qytetit edhe emërtimet e këtyre personaliteteve:

1. Rruga "Fatos Arapi"
2. Ruga "Kujtim Laro"
3. Rruga "Bejkush Birçe"
4. Rruga "Lefter Çipa"

I bëjmë këto propozime për vendosje emri, së pari për arsye identiteti të personalitteteve vlonjatë në rang kombëtar dhe për njohjene tyre e përjetësimin e merituar në qytetin e Vlorës.

Mbetemi me shpresë se propozimi ynë do të gjejë mirëkuptimin tuaj!

**Motivacionet, skeda dhe CV e fushës:**

SHOQATA E SHKRIMTAREVE DHE ARTISTEVE
"PETRO MARKO" VLORE

2. ***Kujtim LARO*** - (Artist i Merituar), padyshim, mbetet një nga kompozitorët më unik në gjithë krijimtarinë e tij të pasur muzikore....
Veç këngëve të muzikës së lehtë shqiptare dhe krijime në gjininë e veprave të ndryshme simfonike, ai ka lënë gjurmë edhe në muzikën e filmit, përmes kolonave muzikore në filmat më të njohur dhe të suksesshëm artistik shqiptar si:
"Lulëkuqet mbi mure", "Në fillim të verës", "Udha e shkronjave", "Nusja dhe shtetrrethimi", "I teti në bronx", "Liri e vdekje", "Nëntori i Dytë", "Partizani i vogël Velo", "Yjet e netëve të gjata", "Vendimi", "Fletët e bardha" dhe "Lule të kuqe, lule të zeza", të cilat mbajnë firmën e krijimtarisë së Tij.....
Ai është cilësuar nga profesionistët më të shquar të fushës si Ennio Morricone i muzikës së filmit Shqiptar....

Ishte dhe mbeti deri në fund të jetës i madh si artist, por edhe më i madh e më Njerezor në modestinë e Tij, i cili, kurrë, por kurrë ndonjëherë nuk kërkoi famë e as tituj...

**Kujtim Laro** (1947-2004) u lind në maj të vitit 1947 në qytetin e Vlorës. Studimet e larta i përfundoi në vitin 1970 në Institutin e Lartë të Arteve, më vonë shërbeu si pedagog për shumë vjet në Akademinë e Arteve. Ka punuar edhe si drejtor artistik pranë Ansamblit të Ushtrisë. Laro mbante titujt "Artist i Merituar" dhe "Naim Frashëri" i klasit të parë. Kompozitori Kujtim Laro ka lënë pas rreth 35 kolona zanore filmash shqiptarë, dhjetëra këngë festivalesh, etj. Në kujtesën e shqiptarëve ai mbahet mend më së tepërmi si kompozitor filmash. Firmën e tij mbajnë kolonat zanore të filmave të njohur, si "I teti në bronz", "Në fillim të verës", "Lulëkuqet mbi mure", "Udha e shkronjave", "Liri a vdekje", "nëntori i dytë", "Militanti", "Vendimi", "Yjet e netëve të gjata", "Nusja dhe shtetrrethimi", "Partizani i vogël Velo", "Fletë të bardha" etj. Krijimi i tij i fundit ka qenë muzika e filmit "Lule të kuqe, lule të zeza". U nda nga jeta në vitin 2004.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr 13023 Prot    Vlorë, më 19.08.2024

VENDIM
Nr 1, Datë 08.07.2024

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit, në mbledhjen e datës 08.07.2024, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura,

VENDOSI:

A-Të miratojë propozimet si më poshtë:
1.Vendosje busti për patriotin Ismail Mekati, në fshatin Brithas.
2.Emërtimin e një rruge në qytet, me emrin Maliq Hadër Habilaj.
3.Vlerësimin me titull"Qytetar Nderi i Vlorës" Prof.Doc.Profit Cauaj.
4.Emërtimin e një rruge, me emrin Bejkush Razo Birçe.
5.Emërtimin e një rruge, me emrin Fatos Arapi.
6.Emërtimin e një rruge, me emrin Lefter Çipa.
7.Emërtimin e një rruge, me emrin Kujtim Laro, kompozitor.
8.Ky Vendim ti përcillet administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë, për p... vendimmarrëse.

KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR
Bardhosh Gaçe

**SHOQATA E SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE "PETRO MARKO", VLORË**

Nr. 31 prot.　　　　　　　　　　　　　　　　Vlorë, e martë, 09. 07. 2024
Regj. nr…
Dosja: Propozime

**LËNDA: PROPOZIM PËR EMËRTIM RRUGËSH**

**KËSHILLIT TË BASHKISË, VLORË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**Z. ERMAL DREDHA**
Z. Kryetar,

Zotërinj anëtarë të këshillit bashkiak!

Shoqata e Shkrimtarëve dhe Artistëve "Petro Marko" Vlorë, e shikon të arsyeshme t'ju drejtohet juve, që në Qytetin "Nderi i Kombit" të Vlorës, që, midis emrave të nderuar të traditës dhe historisë, në këtë 80 vjetor të Çlirimit të Atdheut, të vendosen në rrugë të mundshme dhe të duhura të qytetit edhe emërtimet e këtyre personaliteteve:

1. Rruga "Fatos Arapi"
2. Ruga "Kujtim Laro"
3. Rruga "Bejkush Birçe"
4. Rruga "Lefter Çipa"

I bëjmë këto propozime për vendosje emri, së pari për arsye identiteti të personalitteteve vlonjatë në rang kombëtar dhe për njohjene tyre e përjetësimin e merituar në qytetin e Vlorës.

Mbetemi me shpresë se propozimi ynë do të gjejë mirëkuptimin tuaj!

**Motivacionet, skeda dhe CV e fushës:**

**1. *Fatos ARAPI*** është cilësuar poet elitar shqiptar, kuota më e lartë e krijimit poetik. Ky vlerësim vjen si nga studiuesit e huaj dhe nga kritika letrare shqiptare. Ndërsa studiuesi dhe shkrimtari polak Andrzej Zaniewski e cilëson Fatosin: "poeti më i madh shqiptar".

**Fatos Arapi** (Zvërnec, 19 korrik 1930- Tiranë, 11 tetor 2018) ka qenë një poet, novelist, përkthyes dhe gazetar shqiptar. Shkrimet e Arapit janë çmuar shumë nga lexuesit dhe bashkëkohësit e tij, për të cilat ka marrë çmime të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.

| | |
|---|---|
| **Emri** | Fatos Arapi |
| **Lindur më** | 1930 |
| **Lindur në** | Vlorë |
| **Kombësia** | Shqiptare |
| **Shtetësia** | Shqiptare |
| **Profesioni** | Shkrimtar, gazetar, përkthyes, ekonomist |

U lind i biri i Tol Stavre Arapit në Zvërnec, pranë qytetit të Vlorës, ku kreu shkollimin fillor dhe të mesëm. Studimet e larta i ndoqi në Sofie të Bullgarisë për ekonomi, më pas u kthye të punonte në Tiranë si gazetar dhe lektor për letërsinë moderne shqipe. Puna e tij e parë ishte në vitin 1953 në Komisionin e Planit të Shtetit si Kryetar i Degës së "Artizanatit dhe Industrisë Lokale". Në vitin 1954 ai u transferua në Teknikumin Financiar si mësues i asaj shkolle (Qyteti i Nxënësve) ku dha lëndët: Statistikë, Planifikim dhe Ekonomi Politike. Ai ka punuar pedagog i Ekonomisë në Institutin Bujqësor, po kështu gjatë viteve 1959-1966 ka qenë pedagog i Ekonomisë Politike në Institutin e Lartë Ekonomik të Tiranës.

Në vitin 1966 u dërgua në qarkullim, në Vlorë, ku punoi si mësues i shkollës tetëvjeçare "Ismail Qemali", rreth katër vjet (mars 1966-gusht 1969). Në vitin 1971 ai u emërua pedagog në Fakultetin Histori-Filologji, Universiteti i Tiranës. Në vitin 1973 (pas Plenumit IV) u dërgua në shkollën e mesme të natës "Sami Frashëri", Tiranë, ku qëndroi 10 vjet deri më 1983.

Në vitet 1962 e 1966 botoi vëllimet "Shtigje poetike" dhe "Poezi dhe vjersha". U kritikua më 1973 për vëllimin *Drama e një partizani pa emër*, qëndroi për shumë kohë gati në heshtje deri më 1989.

Në vitin 2008 e fitoi "Kurorën e artë" në manifestimin poetik Mbrëmjet e poezisë strugane dhe është i pari poet shqiptar që e ka fituar këtë shpërblim.

Tituj të veprave

- *Shtigje poetike*, 1962
- *Partizani pa emër*, 1962

SHOQATA E SHKRIMTAREVE DHE ARTISTEVE
"PETRO MARKO" VLORË

- *Poema dhe vjersha*, 1966
- *Ritme të hekurta*, 1968
- *Patat e egra*, 1969
- *Dhjetori i shqetësuar*, 1970
- *Dikush më buzëqeshte*, 1972
- *Poezi të zgjedhura*, 1974
- *Drejt qindra shekujsh shkojmë* 1977
- *Shokët*, 1977
- *Cipa e borës*, 1985
- *Deti në mes*, 1986
- *Ku shkoni ju statuja*, 1990
- *Qezari dhe ushtari i mirë Shvejk, në front diku*, 1995
- *Gjeniu pa kokë*, 1999
- *Na ishte një almë*, 2002
- *E sajoi reja zogun e furtunës*
- *Poezi të zgjedhura në 4 vëllime, 2014*

**Përkthime**

- *Këngë për njeriun, Nikolla Vapcarov*, 1981;
- Poezi, Pablo Neruda, 1989;
- Safo, 1990;
- Antologji e poezisë turke të shekullit XX, 2001.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr 13023 Prot                                        Vlorë, më 19.08.2024

VENDIM
Nr 1, Datë 08.07.2024

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit, në mbledhjen e datës 08.07.2024, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura,

VENDOSI:

A-Të miratojë propozimet si më poshtë:
1.Vendosje busti për patriotin Ismail Mekati, në fshatin Brithas.
2.Emërtimin e një rruge në qytet, me emrin Maliq Hadër Habilaj.
3.Vlerësimin me titull"Qytetar Nderi i Vlorës" Prof.Doc.Profit Canaj.
4.Emërtimin e një rruge, me emrin Bejkush Razo Birçe.
5.Emërtimin e një rruge, me emrin Fotos Arapi.
6.Emërtimin e një rruge, me emrin Lefter Çipa.
7.Emërtimin e një rruge, me emrin Kujtim Laro, kompozitor.
8.Ky Vendim ti përcillet administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë, për p[illegible] vendimmarrëse.

KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR
Bardhosh Gaçe

SHOQATA E SHKRIMTAREVE DHE ARTISTEVE "PETRO MARKO" VLORE

**SHOQATA E SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE "PETRO MARKO", VLORË**

Nr. 31 prot.  
Regj. nr...  
Dosja: Propozime

Vlorë, e martë, 09. 07. 2024

**LËNDA: PROPOZIM PËR EMËRTIM RRUGËSH**

**KËSHILLIT TË BASHKISË, VLORË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**  
**Z. ERMAL DREDHA**  
Z. Kryetar,

Zotërinj anëtarë të këshillit bashkiak!

Shoqata e Shkrimtarëve dhe Artistëve "Petro Marko" Vlorë, e shikon të arsyeshme t'ju drejtohet juve, që në Qytetin "Nderi i Kombit" të Vlorës, që, midis emrave të nderuar të traditës dhe historisë, në këtë 80 vjetor të Çlirimit të Atdheut, të vendosen në rrugë të mundshme dhe të duhura të qytetit edhe emërtimet e këtyre personaliteteve:

1. Rruga "Fatos Arapi"
2. Ruga "Kujtim Laro"
3. Rruga "Bejkush Birçe"
4. Rruga "Lefter Çipa"

I bëjmë këto propozime për vendosje emri, së pari për arsye identiteti të personalitteteve vlonjatë në rang kombëtar dhe për njohjene tyre e përjetësimin e merituar në qytetin e Vlorës.

Mbetemi me shpresë se propozimi ynë do të gjejë mirëkuptimin tuaj!

**Motivacionet, skeda dhe CV e fushës:**

SHOQATA E SHKRIMTAREVE DHE ARTISTEVE "PETRO MARKO" VLORË

4. **Lefter ÇIPA** është ndër etnofolkloristët më të shquar të trashëgimisë kulturore, ndër poetët më interesantë e poet atipik, me botën dhe profilin e tij, sa rebel si stuhia e malit, aq të dhembshuruar si loti i detit. Studiuesi i mirënjohur, akad. Shaban Sinani thekson se poezia e Lefter Çipës të kujton më së pari kangjeljet e Jeronim De Radës, që janë poezi dhe këngë njëherësh. Çipa dhe kënga kanë lidhje të dyanshme, si një binom. Nuk mund të kuptohen dot pa njeri-tjetrin. Me këngën e fuqishme piluriote Lefteri është binjak. Binjak me atë këngë që edhe në Malësi të Gjakovës apo Dibër këndohet aq bukur sa në Labëri e Himarë. Ai është burimi ku ushqehen shumica e këngëtarëve dhe kompozitorëve të sotëm modernë shqiptarë dhe ku shumica e këngëtarëve kanë preferuar që në repertorin e tyre të kenë të kryerenditur poezitë dhe lirikat befasuese të këtij autori. Poezitë tij të këngëzuara e kanë vendin te flamuri me shtizë

**Lefter Çipa** (Pilur, 14 **shkurt** 1942 - 18 shkurt 2021) ka qenë poet shqiptar dhe folklorist i shquar, i njohur në rang kombëtar dhe ndërkombëtar.

Ndër librat e autorit janë: *"Bejkë e bardhë", "Bilbilat e vendit tim", "Shqipëri moj ballëhapur", " Këngët e Ruzanës", "Dheun tim përsipër mbaj", "Për Kosovën prapë do të ngrihem", "Kënga që tret lotin", "Këngët e Akroqeranit", " Ju dua si mallin e zemrës", " Vij nga drita", " Këngët e Atdheut tim" (vëllimi i parë), "Endrra nëpër duar", " Njerëz me dritë"etj.*

Ai është burimi ku ushqehen shumica e këngëtarëve dhe kompozitorëve të sotëm modernë shqiptarë dhe ku shumica e këngëtarëve kanë preferuar që në repertorin e tyre të kenë të

kryerenditur poezitë dhe lirikat befasuese të këtij autori-Është nderuar me çmime dhe dekorata, ndër të cilat me më të lartën "Nderi i Kombit". U nda nga jeta më 18 shkurt 2021.

Veprat e botuara

**Lefter Çipa** është autor i librave

- "Bejke e Bardhë" - (1976);
- "Shqipëri moj ballëhapur" - (1980);
- "Dheun tim përsipër marr" - (1989);
- "Bilbilat e vendit tim" - (1990),
- "Polifonia dhe vjershërimi i polifonisë" - (1994);
- "Bilbili që këndon vetëm" - (1999);
- "Për Kosovën prapë do ngrihem" - (1999);
- Tre vëllime në vitet 1993-94-95 "Kënga që tret lotin",
- "Këngët e Akroqeranit" - (2002)
- "Kënga që tret lotin" - (2002)
- "Këngët e Ruzanës" - (2004)
- "Flet princi i polifonisë Lefter Çipa" - (2007)
- "Engjëj të polifonisë" - (2009)
- "Princi i dashurisë" - (2010)
- "Vij nga drita" - (2014)
- "Këngët e atdheut tim" - (2014)
- "Ëndrra nëpër duar" - (2017)
- "Ju dua si malli i zemrës : vjershërim shpirtëror për polifonët dhe vendin tim, Pilur" - (2018).

SHOQATA E SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE "PETRO MARKO", VLORË

Kryetari

Msc. Albert HABAZAJ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË

Nr 13023 Prot                                                    Vlorë, më 19.08.2024

VENDIM
Nr 1, Datë 08.07.2024

Komisioni Këshillimor për Titujt Vendorë të Nderit, në mbledhjen e datës 08.07.2024, pasi shqyrtoi propozimet e paraqitura,

VENDOSI:

A-Të miratojë propozimet si më poshtë:
1.Vendosje busti për patriotin Ismail Mekati, në fshatin Brithas.
2.Emërtimin e një rruge në qytet, me emrin Maliq Hadër Habilaj.
3.Vlerësimin me titull"Qytetar Nderi i Vlorës" Prof.Doc.Profit Canaj.
4.Emërtimin e një rruge, me emrin Bejkush Razo Birçe.
5.Emërtimin e një rruge, me emrin Fatos Arapi.
6.Emërtimin e një rruge, me emrin Lefter Çipa.
7.Emërtimin e një rruge, me emrin Kujtim Laro, kompozitor.
8.Ky Vendim ti përcillet administratës dhe Këshillit të Bashkisë Vlorë, për p[illegible] vendimmarrëse.

KRYETAR I KOMISIONIT KËSHILLIMOR
Bardhosh Gaçe

**SHOQATA E SHKRIMTARËVE DHE ARTISTËVE "PETRO MARKO", VLORË**

Nr. 31 prot. Vlorë, e martë, 09. 07. 2024
Regj. nr...
Dosja: Propozime

**LËNDA: PROPOZIM PËR EMËRTIM RRUGËSH**

**KËSHILLIT TË BASHKISË, VLORË**

**KRYETARIT TË BASHKISË**
**Z. ERMAL DREDHA**
Z. Kryetar,

Zotërinj anëtarë të këshillit bashkiak!

Shoqata e Shkrimtarëve dhe Artistëve "Petro Marko" Vlorë, e shikon të arsyeshme t'ju drejtohet juve, që në Qytetin "Nderi i Kombit" të Vlorës, që, midis emrave të nderuar të traditës dhe historisë, në këtë 80 vjetor të Çlirimit të Atdheut, të vendosen në rrugë të mundshme dhe të duhura të qytetit edhe emërtimet e këtyre personaliteteve:

1. Rruga "Fatos Arapi"
2. Ruga "Kujtim Laro"
3. Rruga "Bejkush Birçe"
4. Rruga "Lefter Çipa"

I bëjmë këto propozime për vendosje emri, së pari për arsye identiteti të personalitteteve vlonjatë në rang kombëtar dhe për njohjene tyre e përjetësimin e merituar në qytetin e Vlorës.

Mbetemi me shpresë se propozimi ynë do të gjejë mirëkuptimin tuaj!

**Motivacionet, skeda dhe CV e fushës:**

Shoqata Atdhetare
Kulturore "Bolena"
Vlorë

11137
12.07.2024

# Kërkesë

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Vlorë

Lënda: Propozim për emërtimin e një rruge në qytetin e Vlorës me emrin BEJKUSH RAZO BIRÇE, legjenda e futbollit shqiptar, trajneri më i mirë i të gjitha kohërave, i skuadrës kombëtare të futbollit shqiptar.

CV e BEJKUSH RAZO BIRÇAJ.

U lind në Bolenë të Kurveleshit të Vlorës më 15 dhjetor 1936, në një familje atdhetare që patriotizmin e trashëgoi në breza. Është stërnip i Birçe Guxhës, njërit nga kapedanët e mirënjohur të Leskodukajve të Bolenës.
Babai i tij Razo Zeneli ra dëshmor në luftën NAÇL.
U shkollua fillimisht në shtëpinë e fëmijës, Vlorë, shkollën Skënderbej, dhe më pas mbaroi institutin e lartë "Vojo Kushi".
E adhuroi sportin e u shqua si trajner i shumë skuadrave të kategorisë superiore, si: Ekipit të Flamurtarit, Naftëtarit, Partizanit etj. Bëri emër si trajneri më i mirë i të gjitha kohërave në skuadrën e ekipit kombëtar të futbollit. E treti jetën si mësues, pedagog, e trajner i ekipeve të futbollit kombëtar. Për kontribute të shquara është vlerësuar me tituj e dekorata të larta, si:

- Mjeshtër i madh nga Presidenti i Republikës, Bamir Topi.
- Mjeshtër i madh i sportit nga F. Shqiptare e futbollit.
- Personalitet i shquar i Qarkut të Vlorës, nga Qarku Vlorë.

Për kontributin e dhënë në fushën e sportit kombëtar, veçanërisht si trajner i suksesshëm i ekipit kombëtar të futbollit, është në nderim e Bashkisë Vlorës që të emërtohet një nga rrugët e qytetit tonë me emrin BEJKUSH RAZO BIRÇAJ, pas vdekjes. Mendojmë se kërkesa e shoqatës "Bolena" do të merret në konsideratë të favorshme. Respekte për institucionin.

Kryetari i Shoq. Bolena Vlorë
Ruzhdi Bejo
(sign.)

SHOQATA ATDHETARE KULTURORE
BOLENA

Vlorë, 11.07.2024.

SHOQATA E SHKRIMTAREVE DHE ARTISTEVE "PETRO MARKO" VLORE

3. **Bejkush BIRÇE** - një nga emrat më të mëdhenj të futbollit shqiptar, dha kontribut si lojtar dhe trajner i Kombëtares, ndërkohë që ishte edhe zëvendëspresident i FSHF. Një njeri me ide të qartë e karizëm që u përplas madje edhe me regjimin, kur nuk u pajisën me vizë 6 anëtarë të listës së propozuar prej tij dhe kur Panajot Pano mbeti përfundimisht jashtë saj.

**Bejkush Birçe** (Bolenë, 15 shkurt 1943 - Tiranë, 30 qershor 2024 ) ka qenë mësues i edukimit fizik, trajner futbolli si dhe trajner i Kombëtares Shqiptare të futbollit. Birçe e kaloi karrierën e tij si futbollist te Partizani, ndërkohë që e drejtoi më pas edhe si trajner, sikurse bëri me Naftëtarin, Flamurtarin, Lokomotivën e Durrësit dhe Dinamon. Gjithashtu, ai mbahet mend si një nga trajnerët më të shquar të Kombëtares, teksa drejtoi kuqezinjtë në vitet '90, në një periudhë të vështirë për vendin.
Kujtojmë se Çlirimi i vendit e gjeti pa të atin dhe, së bashku me nënën, dy vëllezërit dhe motrën, zbresin në qytetin e Vlorës. Kur ishte vetëm 6 vjeç, ai u transferua në jetimoren e Tiranës, ku përfundoi edhe shkollën 7- vjeçare. Më vonë, regjistrohet në Teknikumin e Sportit në Tiranë, duke ju përkushtuar fortë sportit. Trajneri njohur i futbollit Xhevit Demneri , do bëjë këtë lab të sertë pjesë të skuadrës të të rinjve të Tiranës. Aktivizohet si sulmues, ku shpejtësia është cilësia e tij kryesore. Me të rinjtë bardheblu ai qendroi gjatë periudhës 1952-54, pastaj për një sezon kaloi te modhat e Flamurtarit, përpara se të luante me Partizanin për 8 sezone, deri në vitin 1962.
Pasi vari këpucët në gozhdë ai nisi punë si drejtues në Akademinë e të kuqve e më pas si trajner i ekipit të parë. Një histori interesante, e përsëritur dy herë. Bejkush Birçe, gjatë kohës që ishte pedagog në shkollën ushtarake "Skënderbej", mori propozimin e veçantë që ai nuk e besoi fillimisht. - "Në vitin 1971 më thanë se isha emëruar trajner i Partizanit. Kujtova se bënin shaka me mua". Pa mbyllur mirë ende një sezon ai u largua nga detyra dhe vazhdoi mësimdhënien, deri në vitin 1975, kur mori propozimin për të drejtuar "Flamurtarin" e Vlorës. Ndërtoi një brez të talentuar dhe në fund të viteve 70' u rikthye edhe njëherë në krye të Partizanit. Në karrierë ai drejtoi edhe "Naftëtarin", "Lokomotivën" e Durrësit dhe "Dinamon". Gjithashtu, ai mbahet mend si një nga trajnerët më të shquar të Kombëtares, teksa drejtoi kuqezinjtë në vitet '90, në një periudhë të vështirë për vendin. Birçe po drejtonte "Partizanin" me sukses, si në garat kombëtare, ashtu edhe në ato ndërkombëtare. Por si çdo eksperiencë tjetër, edhe ajo pati problemet e saj. "Partizani" përgatitej për Kupën Ballkanike e Bejkush Birçe dërgoi listën me lojtarët dhe me stafin, që do të pajiseshin me viza, për udhëtimin jashtë. Por lista e tij nuk u miratua. Në klub erdhi një listë tjetër ku i mungonin disa emra nga ata që kishte propozuar Bejkush Birçe, mes të cilëve emrat e ndihmësit të tij në stol, ish-sulmuesi legjendar Panajot Pano, apo dhe mjekut të paharruar, Ali Kastrati. Atëherë trajneri refuzoi të udhëtonte me ekipin, për arsye se nuk ndodheshin emrat që ai kishte propozuar dhe askush nuk kishte të drejtën të propozonte emra të tjerë.

Dule Doloni' 4 mektep 20.11.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VLORË**
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

**KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS**

**Dërgues** Kuso Hyskaj **, Nr.Prot.** ______ **Data** ___.___.**2024**

**Shkurtimi i lëndës** Plotësim dokumentacioni (Relacion)

| | |
|---|---|
| **Për trajtim nga :** | Këshillit Bashkiak / Kom. Vlerësimit |
| (struktura të tjera të ngarkuara | |
| **Me porosi:** | |

**Afati** ☒ **Normal 7 ditë/☐ Prioritet 3 ditë/☐ urgjent brenda ditës/☐ pa afat/për dije/Tjetër __ditë**

**Data** 04.12 **2024, Nr. Prot.** 17978/1 **Nënshkrimi : ( TITULLARI)** 04.12.

**Marrë në dorëzim : ___.___. 2024 Nënshkrimi :** ______________

**Kalon për trajtim ( struktura) :** ______________ ___.___.**2024**

**Me porosinë :** ______________

**Marrë në dorëzim : ___.___. 2024 Nënshkrimi :** ______________

**Kalon për trajtim ( struktura) :** ______________ ___.___.**2024**

**Me porosinë :** ______________

**Marrë në dorëzim : ___.___. 2024 Nënshkrimi :** ______________

**Kalon për trajtim Specialistit :** ______________ ___.___.**2024**

**Me porosinë :** ______________

**Trajtimi i materialit përfunduar më : ___.___2024 Specialisti**

**Trajtimi i materialit pranuar më : ___.___2024 Eprori në shkallë hierarkike**

**Trajtimi i materialit miratuar më : ___.___2024 Eprori në shkallë hierarkike**

**Trajtimi i materialit miratuar më : ___.___2024 Eprori në shkallë hierarkike**

17978/1
04.12.24

# Relacion

Zrj. Elpinigi Mërkuri
Kryetare e Këshillit të Bashkisë Vlorë

DÜLE DALAN MIFTARAJ

Lindi me 5 shtator 1870 ne fshatin Dhemblan te rrethit te Tepelenes.

Rrjedh nga nje familje me tradita patriotike .

Me 5 gusht 1889 mori pjese ne levizjen Kombetare dhe u pagezua me titullin "Luftetar I lirise" ne luften kunder forcave turke.

Ne vitin 1890 thirret nizam nga qeveria Turke . Sherbimin ushtarak e kreu per 10 vjet ne Edrene te Turqise dhe ne Bullgari me detyre Komandant rendi. Ne vitin 1911 lirohet nga ushtria turke dhe bashkohet me ceten patriotike te Ismail Kasos. Merr pjese ne luftimet kunder turqeve ne vitet 1912-1913 ne Kuc e Himare.

Ne vitin 1913 Greqia pushtoi gjithe jugun e Shqiperise , pushtoi edhe Tepelenen . Ne vitin 1914 merr pjese ne luften per clirimin e Tepelenes , Luzatit , Hormoves dhe Laboves. Ne Labove u plagos.

Ne vitin 1914 Greqia e pushtoi Tepelenen , pushtoi dhe dy lagje te Salarise. Greqia ne objektivat e saj kishte hapjen e rruges Tepelene - Vlore , per te pushtuar Vloren.

Ne keto kushte , patriotet e krahines se Lobsit , fshatrat Salari ,Dhemblan ,Matohasanaj , Sinanaj , Martalloz dhe Dorze u organizuan per lufte .

Nen udheheqjen e Ismail Kaso Kasaj u krijua Keshilli I pleqesise se krahines si organi drejtues i luftes .

Dule Dalani perfaqesonte fshatin Dhemblan .

U krijuan organet ekzekutive dhe forcat mbeshtetese te prapavijes .

Duke filluar nga muaji qershor 1914 filloi lufta midis ushtrise greke dhe forcave te krahines se Lobsit ne malin e Gribes.

Lufta vazhdoi per 6 muaj, deri me 22 nentor 1914 kur forcat greke u terhoqen pa mundur te arrijne ne Vlore.

Mali I Gribes u kthye ne Keshtjelle te pamposhtur . Beteja e Malit te Gribes eshte vleresuar me dekoraten " NDERI I KOMBIT "me Dekret nr. 10457 date 14.06.2011 , nga presidenti Bujar Nishani.

Lufta e pare boterore I angazhoi banoret e Lobsit ne te tjera beteja. Lufta e Vlores 1920 ishte objektivi kryesor .

Me 10 maj 1920 vdiq komandanti Ismail Kaso Kasaj. Komandant i cetes se tij u be Dule Dalan Miftaraj. Gjate vitit 1919 Dule Dalani merr pjese ne kuvendet e organizuara per vazhdimin e luftes.

Me 25 maj 1920 ne shtepine e Dule Dalanit behet mbledhja per regjistrimin e vullnetareve per ne luften e Vlores. Me ceten e tij me 5 dhe 6 qershor 1920 rrethoi garnizonin Italian te vendosur ne kalane e Matohasane dhe I detyroi te dorzohen.

Kapiten Rossi u detyrua te dorzohet me 1231 rober.

Me qershor 1920 merr pjese ne luften kunder forcave italiane ne Kuzumbaba , Kote, Mavrove, Drashovice e Kanine.

Ne krye te 150 burrave dhemblanjot , bashke me ceten e Selam Musait beheshin mbi 300 luftetare Dule Dalani tregoi trimeri te rralle.

Ne Babice, mbi telat me gjemba , vendosen gunat , kaluan pengesat dhe luftuan trup me trup me italianet. Me qershor 1920 Dule Dalani bie heroikisht.

Me vendim nr.28 date 15.05.1970 , Komiteti ekzekutiv I Tepelenes e ka shpallur Dule Dalan Miftaraj "Deshmor I atdheut".

Eshte dekoruar me URDHERIN e klasit te pare nga presidenti I Kuvendit Popullor , me dekretin Nr.4736 dt. 31.08.1970.

Komuna e Sinanajt, me vendim Nr.25 dt. 22.06.2004 , Dule Dalani eshte nderuar me titullin "Krenaria e Komunes Sinanaj ".

Dule Dalan Miftaraj u varros me nderime nga Komiteti I Mbrojtjes Kombetare. Fjalimin e mbajti Spiro Koleka .

Materiali eshte marre nga Burime arkivore , nga dosja e luftes se Vlores.

Mendoj se ky relacion e justifikon kerkesen tone per vleresimin e figures se Dule Dalanit nga ky Keshill I nderuar.

Relatuesi

Kaso Hyskaj

[signature]

069 21 95 824

Vlorë

më 03.12.2024

338
11.01.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISSË
INSTITUTI I STUDIMIT TË HISTORISË USHTARAKE

Adresa: Rruga "Petro Nini Luarasi", Pall. 28/2/28 Tiranë Cel. 0699983129 Mail-e: bernardzotaj@yahoo.com

Nr. 5/1 Prot. Datë, më 05 / 01 / 2024

**Lënda:** Propozim për vendosje emri rruge apo institucioni të Dëshmorëve të Atdheut ***MALIQ HADËR HABILAJ*** *dhe* ***LELO HADËR HABILAJ*** .

**Drejtuar:** Z. Ermal **DREDHA**
Kryetari i Bashkisë,
Zj. Elpiniqi **MËRKURI**
Kryetar i Këshillit Bashkiak

**Për dijeni:** Z. Flamur **MAMAJ**
Prefekt i Qarkut, Vlorë

VLORË

***I nderuar Kryetar i Bashkisë,***
***E nderuar Kryetar e Këshillit të Bashkisë Vlorë,***
***I nderuar Prefekt i Qarkut Vlorë,***

Duke ju shprehur mirënjohje për kontributin Tuaj në vlerësimin dhe mbrojtjen e vlerave të LANÇ, Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake, ju sjell në vëmëndjen Tuaj një rast të veçantë, siç janë vëllezërit Habilaj në Vajzë të Vlorës, të rënë dëshmorë në një moshë të re dhe brenda një muaji, korrik 1944.

***MALIQ HADËR HABILAJ*** *dhe* ***LELO HADËR HABILAJ*** janë shpallur "Dëshmor të Atdheut", me vendim nr. 97, dt. 22.09.1972, të Komitetit Ekzekutiv,Vlorë, si dhe me vendim nr. 10 datë 20.05.2003, të Komisionit Qendror i Statusit është "Dëshmor i Atdheut".

Në zbatim të Ligji nr. 109/2018, datë 20.12.2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", **Neni 15, Objektet në nderim të dëshmorëve të atdheut, pika 1.** *Në shenjë nderimi për dëshmorët e atdheut, me vendim të këshillit të qarkut/këshillit bashkiak/prefektit ose me urdhër të ministrit, brenda territoreve nën juridiksionin e tyre ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen, sipas përgjegjësisë përkatëse lapidare,* pllaka përkujtimore, *përmendore si dhe* ***emërtohen mjedise*** *e institucione publike.*

Si dhe në zbatim të Ligji nr. 115/2014, datë 31.7.2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë",

**PROPOZOJMË:**

1. Në shenjë nderimi për Dëshmorët e Atdheut **Maliq Hadër Habilaj** dhe LELO HADËR HABILAJ dhe në kuadrin e 80 vjetorit të rënies së tyre, me vendim të këshillit të bashkisë mund të vendoset për emërtim të ndonjë rruge apo institucioni publike në Bashkinë e Vlorës, me emrin **"Maliq dhe Lelo Habilaj"**, ose me emrin **"Maliq Habilaj"** dhe **"Lelo Habilaj"**.

**Bashkëlidhur:**

-Biografi e Dëshmorët e Atdheut **Maliq Hadër Habilaj** dhe **Lelo Hadër Habilaj.**

-Pjesë nga Ligjin nr. 109/2018 "Për statusin e dëshmorit të atdheut".

**Referuar:**

-Libri i Dëshmorëve, botuar nga Ministria e Mbrojtjes, Tiranë 2012, f. 186-187.

-Maliq Sadushi, "Fshati ynë i mirë" *(Historiku i fshatit Vajzë)*, Shtëpia botuese "ARBRI", Tiranë, 2002, f. 253-254, 257-259.

-Maliq Sadushi, "Ata që nuk harrohen", Botimet Logoreci, 2005, f. 30-50.

-Shkrime në gazeta të kohës.

Ju faleminderit për mbështetjen dhe mbetemi në pritje të vendimit tuaj!

**INSTITUTI I STUDIMIT TË HISTORISË USHTARAKE**

**KRYETAR I BORDIT DREJTUES**

**Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ**

**Biografi e Dëshmorit të Atdheut**
**LELO HADËR HABILAJ**



*Lelo Hadër Habilaj*
*(1928-1944)*

Lindi në vitin 1928, në fshatin Vajzë të rrethit Vlorë. Rrjedh nga një familje me tradita atdhetare dhe patriotike, ku Hadëri, babai ishte luftëtarë në Luftën e Vlorës të vitit 1920.

Pushtuesi italian në vitin 1943 ju dogji shtëpinë, pasi gjithë familja Hadërit ishin luftëtarë të lirisë, të katërt vëllezër: Sulo, Maliq, Lelo dhe Koçi. Edhe Lelo që 15 vjeç u rreshtua në Brigadën V Sulmuese. Në nëntor 1943 bëhet luftëtar i brigadës, në batalionin e dytë, kompaninë e parë.

Lelo mori pjesë në të gjitha luftimet e zhvilluara nga brigada.

Në fshatin Tepçan të Peshkopisë, u ndesh me gjermano-ballistët, ku fillimisht u plagos, por përsëri luftoi dhe nuk u largua nga pozicioni i luftimit. Ra dëshmorë për liri më 30 korrik 1944.

Lelo Hadër Habilaj është shpallur Dëshmor i Atdheut nr. 97, dt.22.09.1972 dhe me Vendim nr. 10 datë 20.05.2003, të Komisionit Qendror i Statusit është "Dëshmor i Atdheut".


DESHMI


ÇERTIFIKATË
E DESHMORIT TË ATDHEUT


më ep nder
emrin shqipëtar"

**Pjesë ligji**

Ligjin nr. 109/2018 "Për statusin e dëshmorit të atdheut". Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë Vendosi:

**Neni 1**

**Objekti**

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i kritereve dhe procedurës për shpalljen ose njohjen e statusit "Dëshmor i atdheut", si dhe të drejtat e përfitimet që rrjedhin nga ky status.

**Neni 15**

**Objektet në nderim të dëshmorëve të atdheut**

1. Në shenjë nderimi për dëshmorët e atdheut, me vendim të këshillit të qarkut/këshillit bashkiak/prefektit ose me urdhër të ministrit, brenda territoreve nën juridiksionin e tyre ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen, sipas përgjegjësisë përkatëse lapidare, pllaka përkujtimore, përmendore si dhe emërtohen mjedise e institucione publike.

9237
12.06.2024

**REPUBLIKA E SHQIPËRISSË**
**ORGANIZAZATA E DESHMORËVE TE LUFTES ANTIFASHISTE NACIONAL - ÇLIRIMTARE**

Adresa Lagjja "Lef Sallata" Vlorë

Nr. ...Prot. Datë, më 12 / 06 / 2024

**Lënda:** Propozim për vendosje emri rruge apo institucioni të Dëshmorëve të Atdheut **Maliq Hadër Habilaj** dhe **Lelo Hadër Habilaj**

**Drejtuar:** Z. Ermal **DREDHA**
Kryetari i Bashkisë,

Zj. Elpiniqi **MËRKURI**
Kryetar e Këshillit Bashkiak

**Për dijeni:** Z. Vangjel Tavo
Prefekt i Qarkut, Vlorë

**VLORË**

I nderuar Z. Kryetar i Bashkisë
E Nderuar Znj. Kryetar i Këshillit të Bashkisë Vlorë,
I nderuar Z. Prefekt i Qarkut Vlorë,

Duke ju shprehur mirënjohje për kontributin Tuaj në vlerësimin dhe mbrojtjen e vlerave të LANÇ, Instituti i Studimit të Historisë Ushtarake, ju sjell në vëmëndjen Tuaj një rast të veçantë, siç janë vëllezërit Habilaj në Vajzë të Vlorës, të rënë dëshmorë në një moshë të re dhe brenda një muaji, korrik 1944.

**Maliq Hadër Habilaj** dhe **Lelo Hadër Habilaj** janë shpallur "Dëshmor të Atdheut", me vendim nr. 97, dt. 22.09.1972, të Komitetit Ekzekutiv,Vlorë, si dhe me vendim nr. 10 datë 20.05.2003, të Komisionit Qendror i Statusit është "Dëshmor i Atdheut".

Në zbatim të Ligji nr. 109/2018, datë 20.12.2018, "Për statusin e Dëshmorit të Atdheut", **Neni 15, Objektet në nderim të dëshmorëve të atdheut, pika 1.** *Në shenjë nderimi për dëshmorët e atdheut, me vendim të këshillit të qarkut/këshillit bashkiak/prefektit ose me urdhër të ministrit, brenda territoreve nën juridiksionin e tyre ngrihen, mirëmbahen dhe ruhen, sipas përgjegjësisë përkatëse lapidare,* pllaka përkujtimore, *përmendore si dhe **emërtohen** mjedise e institucione publike.*

Si dhe në zbatim të Ligji nr. 115/2014, datë 31.7.2014, "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë",

**PROPOZOJMË:**

1. Në shenjë nderimi për Dëshmorët e Atdheut **Maliq Hadër Habilaj** dhe LELO HADËR HABILAJ dhe në kuadrin e 80 vjetorit të rënies së tyre, me vendim të këshillit të bashkisë mund të vendoset për emërtim të ndonjë rruge apo institucioni publike në Bashkinë e Vlorës, me emrin **"Maliq dhe Lelo Habilaj"**, ose me emrin **"Maliq Habilaj"** dhe **"Lelo Habilaj".**

**Bashkëlidhur:**

-Biografi e Dëshmorët e Atdheut **Maliq Hadër Habilaj** dhe **Lelo Hadër Habilaj.**

-Pjesë nga Ligjin nr. 109/2018 "Për statusin e dëshmorit të atdheut".

**Referuar:**

-Libri i Dëshmorëve, botuar nga Ministria e Mbrojtjes, Tiranë 2012, f. 186-187.

-Maliq Sadushi, "Fshati ynë i mirë" *(Historiku i fshatit Vajzë)*, Shtëpia botuese "ARBRI", Tiranë, 2002, f. 253-254, 257-259.

-Maliq Sadushi, "Ata që nuk harrohen", Botimet Logoreci, 2005, f. 30-50.

-Shkrime në gazeta të kohës.

Ju faleminderit për mbështetjen dhe mbetemi në pritje të vendimit tuaj!

**ORGANIZATA E DESHMORËVE TE LUFTES ANTIFASHISTE NACIONAL - ÇLIRIMTARE**

**KRYETARE**

**RESMIE RUCI**

Pranuar

S. Kuci

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA VLORË**
**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE**

## KARTELË SHOQËRUESE E PRAKTIKËS

**Dërgues** Nj. Ad. Orikum, **Nr.Prot** 2358 **Data** 17.12.2024

**Shkurtimi i lëndës** Kërkesë për emërtim mage

| | |
|---|---|
| **Për trajtim nga :** | DU / Komisioni S. Kuci |
| (struktura të tjera të ngarkuara | ✓ |
| **Me porosi:** | |

**Afati :** ☐ Normal 7 ditë/ ☐ Prioritet 3 ditë/ ☐ urgjent brenda ditës/ ☐ pa afat/për dije/Tjetër __ditë

**Data** 24.12 **2024, Nr. Prot** 2067/1 **Nënshkrimi : ( TITULLARI)** ________ 24/12

**Marrë në dorëzim :** ___.___. **2024** **Nënshkrimi :** ______________
**Kalon për trajtim ( struktura) :** ______________ ___.___.**2024**
**Me porosinë :** ______________

______________

**Marrë në dorëzim :** ___.___. **2024** **Nënshkrimi :** ______________
**Kalon për trajtim ( struktura) :** ______________ ___.___.**2024**
**Me porosinë :** ______________

______________

**Marrë në dorëzim :** ___.___. **2024** **Nënshkrimi :** ______________
**Kalon për trajtim Specialistit :** ______________ ___.___.**2024**
**Me porosinë :** ______________

**Trajtimi i materialit përfunduar më :** ___.___**2024** **Specialisti**
**Trajtimi i materialit pranuar më :** ___.___**2024** **Eprori në shkallë hierarkike**
**Trajtimi i materialit miratuar më :** ___.___**2024** **Eprori në shkallë hierarkike**
**Trajtimi i materialit miratuar më :** ___.___**2024** **Eprori në shkallë hierarkike**

20675
24.12.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VLORË
NJESIA ADMINISTRATIVE ORIKUM

Nr. 2358 Prot.                                                                                    Vlorë 17/12/2024

Lënda: Kërkesë për emërtim rruge.

**D.I.I.P**

**Për dijeni: Z. ERMAL DREDHA**
**KRYETARI I BASHKISË**
**VLORË**

Në mbështetje të ligjit 139 për vetqeverisjen vendore, përkatësisht neni 65 pika ë i këtij ligji, Ju kërkojmë:

1-Rruga që bashkon aksin rrugor Tragjas-Orikum tek stacioni elektrik me gjatësi 920 m, gjerësi 4m, pronë publike e Njësisë Administrative Orikum, Bashkia Vlorë të emërtohet me emrin e vjetër " Qafa e Shegës".

2-Rruga që lidhet me aksin e vjetër Orikum-Tragjas në vendin e quajtur "Vila Alimerko me lugun e Gjonet" me gjatësi 750m dhe gjerësi 4m, pronë publike e Njësisë Administrative Orikum, Bashkia Vlorë të emërohet me emrin e vjetër " Lugu i Gjonet".

Bashkëlidhur hartat.

Shpresojmë që kërkesa të merret parasysh!

**ADMINISTRATOR**
**Selim HASKOÇELAJ**

*Adresa: Bulevardi "Princesha Rugjinë", Orikum, 9426, Vlorë; Tel/Fax: 039...*

11.04.24

Data 11.04.2024

# KËRKESË

Lënda : Kërkesë

Drejtuar: Z.Ermal Dredha
Kryetar I bashkisë Vlorë

I Nderuar Kryetar!

Jam Përparim Gega një nga nipërit e gjyshit tonë Ibrahim Skëndaj (Aliu)

IBrahim Skëndaj lindi në Tërbac, Vlorë në 1888. U bë mësues një nga mësuesit e parë të gjuhës së ëmbël shqipe, së bashku me kushëririn e tij Halim Xhelo. Pushtimi i Shqipërisë në vitin 1920 bëri që Ibrahim Skëndaj së bashku me Halim Xhelon të organizonin komitetin e mbrojtjes në luftën e Vlorës 1920. Po keshtu ka qëndruar në krahë të Halim Xhelos dhe në revolucionin demokratik të qershorit 1924, me permbysjen e qeverisë së Nolit dhe ardhjen e qeverisë së Zogut, u mor me tregeti dhe pronat e tij. Ne vitin 1932 u fut ilegalisht në Tërbac, Halim Xhelo. Ibrahim Skendaj si kushëri dhe përkrahës i Halim Xhelos u denua me internim në Pukë.

U lidh që në fillimet e para të L.A.N.Ç ,ndihmoj këtë lëvizje, me të gjitha mundësitë ekonomikisht.

Në operacionin e vitit 1943 iu dogj shtëpia e tij në Tërbac, si një mbështetës I L.A.N.Ç dhe u përndoq nga fashizmi si mbeshtetës dhe perkrahës i flaktë i L.A.N.Ç. U arrestua në shtëpinë e tij në Topana të Vlorës, nga fashizmi nëpërmjet spiunëve të vendosur tek shtëpija e tij. Së bashku me të arrestuar të tjerë nga qyteti I Vlorës, dërgohet në Beograd dhe evakuohet së bashku me 780 të tjerë të burgosur nga Beogradi në kampin famëkeq Mathausen.

Në kamp Ibrahim Skëndaj identifikohej me nr personal të të burgosurit nr 10364.

Vdiq në Mathausen në orën 05.30 datë 26.01.1945 shkaku I vdekjes dobësim zemre, por citohet nga vetë muzeu i Mathausen se shpesh këto vdekje maskoheshin si vdjekje naturale , sipas përgjigje të kërkesës së bërë nga nipi I tij, Nexhip Maskaj MATHAUSEN MEMORIAL, datë 06.03.2017

Trupi i tij prehet në varezat e Dëshmorëve të Atdheut si Dëshmor I Atdheut. Gjyshi jonë ka lënë një pasuri të konsiderueshme dhe një nga këto në Ujë të Ftohtë Vlorë, 180 ha.

I nderuar Kryetar!

Për respektimin e veprës, sakrificës deri në dhënien e jetës për një atdhe të paqtë

Kërkojmë :

Vendosjen e Emrit Ibrahim Skëndaj

A - Në një nga rugët e Qytetit Vlorë

B - Në një nga shkollat e qytetit duke qenë një nga mësuesit e parë të gjuhës shqipe. Mbetemi me shpresë në shqyrtimin sa më shpejt të kërkesës .

Me respekt Niperit dhe Mbesat

Fato Maskaj (Aliaj), e bija

Maksim Gega, nipi

Zamira Velaj, mbesa

Përparim Gega, nipi

Mirjeta Xhelaj, mbesa

Silvira Lalike, mbesa

Nexhip Maska, nipi

Arben Maska, nipi

Anilda Maska, mbesa

Fiona Dollani, mbesa

0682510450

## Murat Miftari

https://geoportal.asig.gov.al




https://geoportal.asig.gov.al ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



# RRUGA "MURAT MIFTARI", RAJONI NR. 5 PROPOZOHET TË ZËVENDËSOHET ME EMRIN "KUJTIM LARO".

**BASHKIA VLORË**

**DREJTORIA E URBANISTIKËS**

*PROPOZIM I EMËRTIMEVE TË RRUGËVE NË VLORË*

MIRATOI:

DREJTOR: ZAMBAK SELMANI

*VENDNDODHJA*

VLORË 2025

A-03






## RRUGA "FEJZO MEMA", RAJONI NR. 3 PROPOZOHET TË ZËVENDËSOHET ME EMRIN "FATOS ARAPI".

**BASHKIA VLORË**

**DREJTORIA E URBANISTIKËS**

*PROPOZIM I EMËRTIMEVE TË RRUGËVE NË VLORË*

MIRATOI:

DREJTOR: ZAMBAK SELMANI

*VENDNDODHJA*

VLORË 2025

A-04

Gani Bejkosala

https://geoportal.asig.gov.al




https://geoportal.asig.gov.al ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 25 50 100 m



**_DEGËZIMI I RRUGËS "GANI BEJKOSALA", RAJONI NR. 4 PROPOZOHET TË ZËVENDËSOHET ME EMRIN "BEJKUSH BIRÇE"._**

**BASHKIA VLORË**

**DREJTORIA E URBANISTIKËS**

**_PROPOZIM I EMËRTIMEVE TË RRUGËVE NË VLORË_**

MIRATOI:

DREJTOR: ZAMBAK SELMANI

**_VENDNDODHJA_**

VLORË 2025

A-05






**DEGËZIMI I RRUGËS "FEJZO GJOMEMA", RAJONI NR. 2 PROPOZOHET TË ZËVENDËSOHET ME EMRIN "LEFTER ÇIPA".**

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E URBANISTIKËS

*PROPOZIM I EMËRTIMEVE TË RRUGËVE NË VLORË*

MIRATOI:

DREJTOR: ZAMBAK SELMANI

*VENDNDODHJA*

VLORË 2025

A-01






**DEGËZIMI I RRUGËS "QEMAL GORISHOVA", RAJONI NR. 5 PROPOZOHET TË ZËVENDËSOHET ME EMRIN "LELO HABILAJ".**

BASHKIA VLORË

DREJTORIA E URBANISTIKËS

*PROPOZIM I EMËRTIMEVE TË RRUGËVE NË VLORË*

MIRATOI:

DREJTOR: ZAMBAK SELMANI

*VENDNDODHJA*

VLORË 2025

A-07

## Dede Gjon Luli

https://geoportal.asig.gov.al




https://geoportal.asig.gov.al ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.



**_DEGËZIMI I RRUGËS" DEDË GJON LULI", RAJONI NR. 1 PROPOZOHET TË ZËVENDËSOHET ME EMRIN "DULE DALANI"._**

**BASHKIA VLORË**

**DREJTORIA E URBANISTIKËS**

**_PROPOZIM I EMËRTIMEVE TË RRUGËVE NË VLORË_**

MIRATOI:

DREJTOR: ZAMBAK SELMANI

**_VENDNDODHJA_**

VLORË 2025

A-06

## HARTA E VENDNDODHJES SË RRUGËS (gjatësia ~920m)



## HARTA E VENDNDODHJES SË RRUGËS (gjatësia ~750m)



# printo_20250617_1416

https://geoportal.asig.gov.al
Data e Printimit: 17.06.2025.




https://geoportal.asig.gov.al:ofron të dhëna gjeohapësinore të ofruara nga autoritetet publike përgjegjëse.
Përgjegjësia për saktësinë e të dhënave është e autoritetit publik që i ka krijuar ato.

0 200 400 800 m

Sistemi koordinativ: KRGJSH
Projektimi: KRGJSH